

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8000
E mërkurë, 26. shkurt 2025
Çmimi 0.50

Presidentja Osmani priti në takim gjimnastet kampione, motrat Lisa dhe Vilëza Zeqiri **F.6**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

DËSHIMI I PRANIMIT TË KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS DHE PËRGJEGJËSIA E QEVERISË SË KOSOVËS **F.6**

Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla
BERISHA



AKTUALE



INTERESIM ENDE I ULËT I SHOQIPTARËVE TË GREQISË PËR T'U REGJISTRUAR PËR VOTIMET E 11 MAJIT **F.2**

QEVERIA E KOSOVËS THEMELON KËSHILLIN SHTETËTOR PËR SHËNIMIN E 27-VJETORIT TË EPOPESË SË UÇK-së **F.7**

EKONOMI



ZRRE: KOMPANITË ENERGETIKE KËRKOJNË RRRITJEN E ÇMIMIT TË RRYMËS **F.8**

SPORT

SOT ZHVILLOHEN DY NDESHJET ÇEREKFINALE TË KUPËS **F.10**

ZBATIMI I KONTRATËS KOLEKTIVE, IBRAHIMI KËRKON NGA QEVERIA TA NDALOHË KOLAPSIMIN FINANCIAR TË KOMUNAVE

F.4-5



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, ka ngritur shqetësimin

për gjendjen e rëndë financiare të komunave, duke kërkuar ndërhyrje urgjente nga Qeveria e Kosovës për

ta parandaluar kolapsin financiar dhe bllokimin e projekteve kapitale për vitin 2025

HARADINAJ PËR KURTIN: NA LA PA NATO-N, PA SHBA-NË DHE PA EU-n **F.2**



TARIFAT EVENTUALE TË SHBA-SË PËR MALLRAT E BE-SË MUND T'I PREKIN EKSPORTET E KOSOVËS **F.4**



RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Interesim ende i ulët i shqiptarëve të Greqisë për t'u regjistruar për votimet e 11 majit

TIRANË, 25 SHKURT - Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, deri të martën e 24 shkurtit mbi 80 mijë shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Greqi kanë kërkuar të regjistrohen për të votuar në zgjedhjet e 11 majit në Shqipëri. Qytetarët shqiptarë në Greqi përbëjnë rreth 28 % të kërkesave për të votuar nga rreth 227 mijë kërkesa që janë deri tani në total nga diaspora.

Qytetarët shqiptarë në Greqi renditen pas qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Itali, të cilët kanë dorëzuar deri më tani në KQZ rreth 111 mijë kërkesa.

Sipas bazës elektronike të të dhënave të KQZ-së, rreth 50 mijë qytetarëve shqiptarë që jetojnë në Greqinë fqinje u është pranuar kërkesa dhe janë miratuar si zgjedhës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa rreth 13 mijë prej tyre janë refuzuar për mungesë dokumentacioni.



Të dhënat e Ministrisë greke të Emigracionit në janar të këtij viti flasin se rreth 277 mijë shqiptarë rezultojnë me lejeqëndrimi të rregullta në Greqi duke përbërë 55.9 % të të huajve në këtë vend. Kësaj shifre për shqiptarët në Greqi i shtohen edhe rreth 15 mijë pjesëtarë të pakicës greke të cilët kanë në Greqi një status

tjetër, atë të "homogjenit" dhe e kanë të drejtën për të votuar në Shqipëri pasi e kanë ruajtur nënshtetësinë shqiptare edhe pas emigrimit në Greqi. Por, sipas analistëve të shtypit nga Athina, shifra e shqiptarëve me dokumente shqiptare në Greqi, por që nuk kanë ende lejeqëndrimi greke, mund të

jetë shumë më e lartë se të dhënat e ministrisë greke të Emigracionit.

Regjistrimi deri tani i rreth 50 mijë për të votuar në zgjedhjet shqiptare flet për një ritëm ende të ulët ndërkohë që afati i regjistrimit për të votuar skadon më 4 mars.

Partitë kryesore politike shqiptare kanë zhvilluar ditët e fundit fushata intensive në disa zona të Greqisë të banuara në masë të madhe nga emigrantët shqiptarë duke i nxitur të regjistrohen dhe të votojnë.

Ndërkohë autoritetet shqiptare ndërmorën disa hapa në fillim të këtij viti për të mundësuar në disa ishuj grekë pajisjen me dokumente identiteti të qytetarëve shqiptarë përmes platformave të lëvizshme për t'u mundësuar regjistrimin në zgjedhjet shqiptare të 11 majit. Sipas vlerësimeve të Institutit shqiptar të Statistikave, në studimin "Diaspora në shifra

2020", numri i shtetasve shqiptarë jashtë vendit llogaritet deri në këtë vit të jetë rreth 1,68 milion të cilët përbejnë rreth 37 % të shtetasve shqiptarë në total.

Ndërkohë sipas të dhënave jozyrtare, në janar të vitit 2025 numri i shqiptarëve në diasporë ka shkuar në rreth 1,75 milion.

Deri mesditën e së martës së 24 shkurtit në bazën e të dhënave për regjistrimin e votuesve nga jashtë të KQZ-së rezultoni 226 780 shtetas shqiptarë që kanë bërë kërkesë për regjistrim për të votuar me postë në zgjedhjet parlamentare të 11 majit.

Deri tani, sipas KQZ-së, 181 371 shtetasve u është miratuar kërkesa dhe 39 282 u është refuzuar.

Qarqet me numrin më të madh të zgjedhësve nga jashtë vendit të regjistruar deri më tani janë Tirana, Fieri, Durrësi, Elbasani, Korça dhe Vlora.

Ligjvënësit ukrainas e mbështesin Zelenskyn pasi Trumpi e quajti "diktator"

KIEV, 25 SHKURT - Parlamenti i Ukrainës, në një shfaqje simbolike të mbështetjes, ka miratuar një rezolutë për ta rikonfirmuar legjitimitetin e presidentit Volodymyr Zelensky si udhëheqës i shtetit, pas pikëpyetjeve të ngritura nga Shtetet e Bashkuara dhe Rusia lidhur me ligjshmërinë e mandatit të tij.

Rezoluta vë në pah tensionet në mes të Uashingtonit dhe Kievit pasi presidenti amerikan Donald Trump javën e kaluar e quajti Zelenskyn "diktator pa zgjedhje" për shkak të dështimit të mbajtjes së zgjedhjeve në kohë lufte dhe e akuzoi Kievin për nisjen e luftës.

Presidenti rus Vladimir Putin ka pretenduar se nuk mund të ketë bisedime të paqes me Ukrainën sepse Zelensky nuk është udhëheqës legjitim i shtetit për shkak se mandati i tij presidencial fillimisht ishte paraparë të përfundonte në maj të vitit 2024. Megjithatë, sipas Kushtetutës ukrainase, Zelensky

mbetet në detyrë si president i vendit për shkak se shteti shpall gjendje lufte për shkak të pushtimit rus të Ukrainës, një aspekt që e përmendën ligjvënësit ukrainas kur e miratuan rezolutën në Parlament, që njihet si Verkohona Rada, më 25 shkurt në Kiev. "Gjendja e luftës në Ukrainë, e shpallur në përgjigje të pushtimit në shkallë të gjerë të nisur nga Rusia, nuk lejon zgjedhje sipas Kushtetutës ukrainase. Në të njëjtën kohë populli ukrainas është i bashkuar në mendimin se zgjedhje të tilla duhet të mbahen pasi të përfundojë lufta", u tha në rezolutë.

Gjendja e luftës u shpall nga Kiev një ditë pasi Kremli nisi pushtimin e shtetit fqinj në shkurt të vitit 2022.

Zyrtarët ukrainas vazhdimisht kanë përmendur se aspektet praktike, po ashtu edhe ato ligjore, e bëjnë të pamundur mbajtjen e zgjedhjeve. Ata kanë theksuar se shqetësimet e



mëdha për sigurinë, duke argumentuar se vendotimet e mbushura me njerëz do të ishin caqe të lehta për ushtrinë ruse e cila ka sulmuar vazhdimisht objektivat civile, përfshirë shkollat, spitalet dhe ndërtesat e banimit gjatë tre vjetëve të fundit. Për më tepër, miliona ukrainas janë larguar nga shteti për shkak të luftës dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhje duhet të merret parasysh, thanë zyrtarët.

Këto shqetësime janë mbështetur nga dhjetëra grupe të shoqërisë civile të cilat javën e

kaluar lëshuan një deklaratë të përbashkët ku u tha se nuk ka mundësi që të mbahen zgjedhje në rrethanat aktuale. "Vetëm pas përfundimit të luftës dhe arritjes të një paqeje të qëndrueshme... do të jetë e mundur që të organizohen zgjedhje të lira, fer dhe demokratike", thanë ata në deklaratën e përbashkët.

Zelensky, i cili nuk ka treguar nëse do të garonte në zgjedhje, ka thënë se zgjedhjet mund të mbahen këtë vit nëse hiqet vendimi për gjendjen e luftës, diçka që do të ishte e mundur të ndodhte pasi të arrihej një

marrëveshje për ndaljen e luftimeve.

Bisedimet për një marrëveshje të paqes janë shtuar javën e fundit edhe pse është e paqartë se si do të arrihet paqja.

Zyrtarët e lartë amerikanë dhe rusë kanë mbajtur bisedime në Arabinë Saudite javën e kaluar lidhur me përfundimin e luftës. Këto ishin bisedimet e para formale të nivelit të lartë në mes të Uashingtonit dhe Moskës që nga nisja e luftës në Ukrainë më 2022.

Pavarësisht prej disa sigurive dhe thirrjeve nga udhëheqësit evropianë që zyrtarët ukrainas të përfshihen në negociatë, Ukraina u la jashtë këtyre bisedimeve.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, më 24 shkurt për Fox News, pas takimit me Trumpin në Shtëpinë e Bardhë, deklaroi se një armëpushim në mes të Ukrainës dhe Rusisë mund të arrihet "në javët në vijim". "Pasi bisedova me presidentin Trump, unë plotësisht besoj se ka rrugë përpara", tha Macroni.

Rusia nuk do të pranohet prapë në G7, thotë ministri gjerman

BERLIN, 25 SHKURT - Rusia nuk do të kthehet në G7 (grupin e shtatë shteteve më të industrializuara të botës) siç ka kërkuar presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka thënë ministri i Financave i Gjermanisë, Joerg Kukies. "G7 e dënon shumë qartë luftën e agresionit të Rusisë, veçanërisht në përvjetorin e tretë të sulmit brutal nga

Rusia", ka thënë Kukies në një intervistë për agjencinë e lajmeve "Reuters", duke shtuar se propozimi i Trumpit nuk do ta sigurojë mbështetjen e nevojshme unanime.

Kukies u emërua ministër i Financave nga kancelari në largim, Olaf Scholz, në nëntor, pasi koalicioni qeverisës i Scholzit u rrëzua me votë mosbesimi, dhe pritet të

shërbejë në këtë pozitë derisa të formohet një qeveri e re pas zgjedhjeve të së dielës të cilat i fituan konservatorët e Friedrich Merzit.

Një luftë tregtare ndërmjet ShBA-së dhe Evropës mund të shmanget, teksa të dyja palët janë të gatshme të negociojnë, ka thënë Kukies. "Askush s'është i interesuar të nisë luftë tregtare", është shprehur ai.



Haradinaj për Kurtin: Na la pa NATO-n, pa ShBA-në dhe pa EU-n

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka drejtuar akuza për kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Haradinaj ka shkruar në "Facebook" se Kurti na la pa NATO, pa ShBA-në dhe pa EU-n. "Na la pa NATO, pa ShBA, pa EU. Na solli

Asociacionin më të keq të mundshëm. Na vendosi nën sanksione. Dobësoi biznesin, lodhi punëtorët e sektorit privat dhe publik. Na bëri të varur nga importi i energjisë dhe na e shtrenjtoi, dhe po na e shtrenjton prapë çmimin. I poshtëroi vlerat

e lirisë duke lënë veteranët e UÇK-së jashtë pagës minimale me ndihmën e Listës Serbe. Na përçau në Kosovë, por edhe në rajon, me të gjithë shqiptarët, edhe në diasporë. Ky është e keqja!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



SOT NIS NUMËRIMI I VOTAVE NGA PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 25 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tha se më 26 shkurt do të nisë numërimi i votave të qytetarëve që kanë votuar në përfaqësitë diplomatike të Kosovës nëpër botë.

Gjatë mbledhjes së KQZ-së u tha se numërimi i këtyre votave pritet të nisë pasditen e së mërkurës.

Më 8 shkurt për herë të parë Kosova organizoi votimin fizik të pjesëtarëve të diasporës në përfaqësitë diplomatike të shtetit nëpër botë. Votimet u mbajtën në 43 vendvotime në 16 ambasada dhe 14 konsullata të Kosovës, në 19 shtete të ndryshme të botës.

Pjesëmarrja ishte 73.56 për qind, përkatësisht nga 20 324

persona të regjistruar për të votuar në përfaqësitë diplomatike, 15 552 prej tyre e shfrytëzuan këtë të drejtë.

Deri më tani për zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit ka përfunduar numërimi i votave të rregullta për partitë dhe kandidatët për deputetë. Aktualisht janë duke u skenuar listat e votuesve, në mënyrë që të mund të vazhdohet numërimi i votave me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe atyre me postë.

Përveç votimit nëpër ambasada dhe konsullata, mërgata ka votuar edhe përmes postës. Sipas të dhënave të KQZ-së, nga 69 000 pako me fletëvotime janë aprovuar 62 990 zarfe,



ndërkaq 4 865 janë refuzuar. Arsyet e refuzimit të tyre janë të ndryshme. Shembull, 729

zarfe nuk janë vlerësuar fare pasi aplikuesit kishin zgjedhur të votonin fizikisht në

përfaqësitë diplomatike. Arsyet e tjera të refuzimit përfshijnë dërgimin e zarfeve me fletëvotim më shumë se një herë, pakot nuk kanë pasur vulë postare e të tjera. Sipas rezultateve preliminare, që përfshijnë numërimin e votave të rregullta, Lëvizja Vetëvendosje është e para me 40.80 për qind të votave të fituara, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 22.05 për qind. E treta ka dalë Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.64 për qind të votave, pasuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.46 për qind të votave të fituara. Nga partitë e komunitetit serb, më së shumti vota ka marrë Lista Serbe, përkatësisht 4.62 për qind.

OSMANI PRET NË TAKIM AMBASADORIN SUEDEZ, NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR MBËSHTETJE TË PRESIDENCËS ME EKSPERTIZË PROFESIONALE



PRISHTINË, 25 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, me të cilin ka diskutuar rreth zhvillimeve të fundit në vend si dhe për bashkëpunimin në tejkalimin e sfidave të përbashkëta në kontinentin evropian. Gjatë këtij takimi presidentja Osmani, ambasadori Westerlund dhe drejtori

ekzekutiv i Balkan Policy Research Group, Naim Rashiti, kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi i cili do t'i sigurojë Zyrës së Presidentes mbështetjen e shtetit suedez nëpërmjet ekspertizës profesionale nga fushëveprimtaria e institucionit të Presidencës. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit presidentja Osmani falënderoi ambasadorin Westerlund për përkrahjen e vazhdueshme të

Suedisë ndaj Kosovës, duke theksuar rëndësinë e partneritetit për forcimin e institucioneve demokratike dhe avancimin e agjendës evropiane të vendit tonë.

Ky memorandum bashkëpunimi shënon një tjetër hap konkret në drejtim të përfortimit të kapaciteteve institucionale dhe krijimit të politikave të bazuara në ekspertizë dhe praktikë më të mira ndërkombëtare.

Policia e Kosovës ndalon në Jarinjë një të dyshuar për krime lufte

PRISHTINË, 25 SHKURT - Në pikëkalimin kufitar të Jarinjës - që lidh Kosovën me Serbinë - Policia e Kosovës tha se ka ndaluar një person të dyshuar për krime lufte kundër popullatës civile. Sipas njoftimit, personi i ndaluar, i identifikuar me inicialet D. R., dyshohet se ka kryer këtë veprë penale në komunën e Gjakovës në periudhën 7-10 maj të vitit 1999, "duke vepruar në grup dhe të organizuar si zyrtar të mobilizuar me njësi të përbëra nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë".

Policia tha se në prani të avokatit të tij mbrojtës, i dyshuari është intervistuar nga zyrtarët policorë. "Prokurori i rastit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është informuar për të gjitha veprimet hetimore dhe ka lëshuar aktvendimin për ndalimin e të dyshuarit për 48 orë në përputhje me procedurat ligjore në fuqi", u tha në njoftim.

Organet e Kosovës kanë ngritur së fundi dhjetëra aktakuza lidhur me krime që kanë ndodhur gjatë luftës më

1998-'99. Krimet e luftës në Kosovë nga viti 2000 deri më 2008 ishin hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), më pas nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Ndërkaq, nga viti 2018, EULEX-i ua ka dorëzuar lëndët prokurorive dhe gjykatave të Kosovës.

Në luftën e fundit në Kosovë janë vrarë më shumë se 13 000 persona dhe janë zhdukur mijëra të tjerë. Më shumë se 1 600 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur dhe pjesa më e madhe e tyre janë shqiptarë.





ZBATIMI I KONTRATËS KOLEKTIVE, IBRAHIMI KËRKON NGA QEVERIA TA NDALOJË KOLAPSIMIN FINANCIAR TË KOMUNAVE

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, ka ngritur shqetësimin për gjendjen e rëndë financiare të komunave, duke kërkuar ndërhyrje urgjente nga Qeveria e Kosovës për ta parandaluar kolapsin financiar dhe bllokimin e projekteve kapitale për vitin 2025

PRISHTINË, 25 SHKURT - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka kërkuar nga qeveria t'i ndihmojë komunat e Kosovës për zbatimin e kontratës kolektive. Ai ka bërë me dije se nëse një gjë e tillë nuk ndodh, komunat rrezikojnë të kolapsojnë. Në një deklaratë për gazetën "Nacionale", ai ka përmendur pasojat që mund t'i kenë komunat. "Komunat rrezikohen që të mos zbatojnë projekte kapitale në

vitin 2025 dhe mbylljen e xhirollogarive të tyre. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është duke i përkrahur komunat sa i përket zbatimit të kontratës kolektive dhe me këtë rast komunat rrezikojnë që të mos kenë mjete për investime kapitale, që t'iu mbylljen xhirollogaritë bankare dhe që shumë projekte të parapara me buxhetet komunale të mos zbatohen. Kjo vjen si pasojë e neglizhencës së institucioneve qendrore të

cilat për disa vjet nuk janë duke i marrë parasysh kërkesat e komunave. Që në fillim të këtij viti vetëm disa komunave iu kanë shkuar faturat mbi 35 milionë euro, ku mbi 25 milionë euro janë borxh ndaj përfituesve, ndërsa mbi 10 milionë euro janë tarifë për përbaruesit e që me një vendim të qeverisë apo Kuvendit të Republikës së Kosovës kjo gjakderdhje financiare që është mbi 10 milionë euro të deritanishme mund të ndalohet", ka vlerësuar ai. Ai ka treguar faturat që komunat kanë paguar deri më tani. "Këto janë mjete të taksapaguesve të Republikës së Kosovës dhe po që se Qeveria do të menaxhonte procesin si duhur, atëherë tarifën për përbaruesit nuk do të ndodhnin. Shumica absolute e këtyre mjeteve do i merren komunave nga projektionet buxhetore për investime kapitale dhe që

këto mjete po i merren për shkak të zbatimit të kontratave kolektive. Në vijim po i paraqesim vetëm disa komuna që kanë pranuar vetëm në vitin 2025 faturat për zbatim të kontratës kolektive; Ferizaj 9.5 milionë euro, Prizreni 5.5 milionë euro, Lipjani 3.8 milionë euro, Malisheva 2.6 milionë euro, Rahoveci 2.1 milionë euro, Vitia 2.1 milionë euro, Mitrovica 1.7 milion euro, Skenderaj 1.6 milion euro, Kaçaniku 1.5 milion euro, Gjakova 1.4 milion euro, Suhareka 1.3 milion euro", ka thënë ai. Ndër të tjera, ai ka treguar edhe shifrën e eurove që deri më tani kanë paguar komunat. "Deri në fund të vitit të kaluar komunave iu janë marrë padrejtësisht mbi 125 milionë euro ku shumica absolute e këtyre mjeteve janë marrë nga kategoria për investime kapitale dhe kjo ka ndodhur më së shumti në tri

vitet e fundit. Duhet të jemi në dijeni se këtë vit janë edhe zgjedhjet lokale dhe se mungesa e përkrahjes nga niveli qendror ndaj komunave në zgjidhjen e problemit kryesor e që është kontrata kolektive do t'i dëmtojë komunat në masë të madhe. Kemi kërkuar dhe kërkojmë që këtë çështje ta zgjidhë niveli qendror sepse niveli qendror i ka nënshkruar kontratat kolektive. Me këtë trend, edhe këtë vit komunave mund t'u merren mbi 50-60 milionë euro e për pasojë qytetarët që jetojnë nëpër komunat e Republikës së Kosovës nuk do t'i gëzohen realizimit të shumë projekteve që do ta përmirësonin jetën e tyre. Kërkesë e Asociacionit të Komunave të Kosovës është që qeveria të zgjohet dhe të marrë në konsideratë kërkesat e komunave për zgjidhjen e këtij problemi", ka vlerësuar Ibrahim.

KURTI DHE AMBASADORI I FINLANDËS FLASIN PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE PAS ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT



PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, me të cilin kanë diskutuar një sërë çështjesh me interes të përbashkët. Sipas njoftimit për medie, gjatë këtij takimi janë theksuar marrëdhëniet bilaterale në mes të Kosovës dhe Finlandës si dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Ambasadës së Finlandës dhe Qeverisë së

Kosovës. Temë tjetër ishin zgjedhjet e 9 shkurtit dhe hapat drejt formimit të institucioneve pas certifikimit të rezultateve zgjedhore. "Marrëdhëniet bilaterale Kosovë - Finlandë, bashkëpunimi ndërmjet ambasadës finlandeze dhe qeverisë, zgjedhjet e 9 shkurtit dhe hapat drejt formimit të institucioneve pas certifikimit të rezultateve, ishin temat qendrore të bashkëbisedimit", u tha në njoftim.

U diskutua edhe për situatën e sigurisë në rajon dhe në kontinent, veçanërisht në kontekstin e luftës në Ukrainë, e cila ka mbushur tri vjet që kur ka filluar agresioni ushtarak rus. Në fund, Kurti falënderoi ambasadorin Nissinen për mbështetjen dhe kontributin e vazhdueshëm të Finlandës dhënë Kosovës, duke e vlerësuar partner të rëndësishëm në avancimin e proceseve demokratike dhe integruese të Kosovës.

FEITH, THIRRJE KOSOVËS: MOS E MERRNI TË MIRËQENË MBËSHTETJEN E SHBA-SË TANI E TUTJE

PRISHTINË, 25 SHKURT - Pieter Feith, ish-përfaqësuesi i BE-së për Kosovën, tha në një intervistë për "Euronews Albania", se klasa politike në Kosovë nuk duhet ta marrë të mirëqenë mbështetjen e ShBA-së në drejtimin e Donald Trumpit. Feith u shpreh se administrata e re është duke parë interesin ekonomik mbi gjithçka tjetër dhe në këtë

kuadër Serbia është shumë më tërheqëse sa iu përket mineraleve që përbëjnë interes për të. "Kam një këshillë miqësore për klasën politike në Kosovë: mos e merrni mbështetjen amerikane si të mirëqenë nga sot e tutje, gjërat kanë ndryshuar. Në dialogun me Serbinë, Serbia është tërheqëse jo vetëm nga BE, por edhe nga ShBA për shkak të

mineraleve që përbëjnë interes për ShBA, që ditët e sotme po e sheh të ardhmen përmes inteligjencës artificiale. Qeveria e Kosovës duhet të kuptojë se duhet të mbetet fleksibël ku të jetë e nevojshme, sigurisht pa lëshuar interesin kombëtar të saj. Do të ishte e mençur që t'i normalizojmë sa më parë marrëdhëniet me Serbinë", tha ai.



DYSHIMI PËR "TREN BULLGAR" NË NJË KUTI NË GJAKOVË, PDK-ja KËRKON KOMISION HETUES

PRISHTINË, 25 SHKURT - Anëtari i PDK-së në KQZ, Ilri Gashi, në mbledhjen e mbajtur të martën të KQZ-së, ka kërkuar krijimin e një komisioni hetimor, për një kuti votimi në Gjakovë me numër 02-07-06, në të cilën dyshohet se është votuar përmes atij që quhet "treni bullgar". Gashi ka thënë se ajo kuti s'është dashur të numërohet deri në një hetim përfundimtar. "Mendoj që duhet të trajtohen edhe disa çështje për të cilat kanë ndodhur gjatë ditës së votimit, që për njërin nga këto është në trajtim edhe nga Prokuroria. Kërkoj nga ju që të bëni një Komision për të



hetuar një kuti në Gjakovë, për të cilën është thënë se ka

qarkulluar 'treni bullgar', bëhet fjalë për kutinë 02 07 06,

e cila është objekt hetimi. Ajo kuti është numëruar, kërkoj që të largohet nga rezultati deri në një hetim përfundimtar. Kërkoj ta bëni një komision, pavarësisht përfundimit të organeve të drejtësisë", ka thënë Gashi, duke iu drejtuar drejtorit të Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Partive Politike, Besnik Buzhalës. Megjithatë me një kërkesë të tillë të anëtarit të PDK-së s'është pajtuar anëtari i LV-së në KQZ, Alban Krasniqi, duke thënë se tashmë për të njëjtën kuti është duke u zhvilluar një hetim nga Prokuroria e Shtetit

dhe se do të veprohet ndaj të njëjtës në momentin që do të ketë epilog hetimi. "Që të mos të dalë në media ky këndvështrim i njëanshëm dhe joprofesional i kolegut, sepse për kutinë në Gjakovë organet po merren dhe ne s'kemi nevojë të ndërmarrim veprim tjetër, përveç asaj që organet e hetuesisë, ata i kanë marrë materialet, i shikojnë dhe në bazë të tyre dalin me një raport dhe ne veprojmë", ka thënë Krasniqi, duke theksuar se numërimi është dashur të ndodhë për ta ditur gjendjen reale të kutisë. "Besoj ajo është bërë", ka thënë Krasniqi.

Murati: Ende pa përfunduar muaji shkurt janë bërë 23 118 lëndë përmbartimore që janë dorëzuar kundër komunave në Thesar

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë të martën se ende pa përfunduar muaji shkurt janë bërë 23 118 lëndë përmbartimore që janë dorëzuar kundër komunave në Thesar për kontratën kolektive të nënshkruar

paligjshëm. "Shuma e kërkuar për përmbartim është 35.8 milionë euro. 25.6 milionë janë për borxhin ndaj përfituesve, kurse 10.2 milionë euro janë për tarifën e përmbartuesve. Siç edhe kanë deklaruar nga vetë Asociacioni i Komunave,

dëmi buxhetor tashmë ka tejkalar mbi 100 milionë euro. Por deri më tani nuk kemi dëgjuar për ndonjë rast të hapur nga prokuroria ndaj atyre që nënshkruan paligjshëm dhe i shkaktuan buxhetit të shtetit dëmtrim prej mbi 100 milionë eurosh.

Çështja tjetër shqetësuese e që duhet të merren organet e rendit është edhe abuzimi i përmbartuesve me tarifën. Nuk janë të rralla rastet kur tarifa e përmbartuesit tejkalon edhe vlerën e borxhit që përmbartohet", ka shkruar Murati në "Facebook".



Varroset Bajram Qerkini, zëri i familjarëve të personave të pagjetur

MITROVICË, 25 SHKURT - Kryetari i Shoqatës "Zëri i Prindërve", Bajram Qerkini, i cili vdiq një ditë më parë, është varrosur të martën në Mitrovicë. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit, përveç

familjarëve, morën pjesë edhe përfaqësues të autoriteteve të ndryshme qendrore dhe komunale si dhe shumë qytetarë. Kushtrim Gara, nga Komisioni Qeveritar për

Personat e Pagjetur, tha se "Baca Bajram nuk u dorëzua asnjëherë". "Ishte një zë i palodhshëm në kërkimin e së vërtetës dhe drejtësisë", ka thënë Gara. I njohur si "Baca Bajram",

Qerkini ishte i angazhuar për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë dhe pas luftës në Kosovë, në mesin e të cilëve është edhe djali i tij Reshati, për fatin e të cilit ende nuk dihet.



DËSHTIMI I PRANIMIT TË KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS DHE PËRGJEGJËSIA E QEVERISË SË KOSOVËS



Shkruan: Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

1. Dështimi diplomatik dhe pasojat për Kosovën

Dështimi i Kosovës për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës (KiE) përfaqëson një pengesë të madhe për afirmimin e shtetësisë së saj në arenën ndërkombëtare dhe përpjekjet për të siguruar njohje të mëtejshme. Këshilli i Evropës, si organizatë kyçe për të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe demokracinë, është një platformë thelbësore për fuqizimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Megjithatë, ky proces ka dështuar, dhe përgjegjësia bie kryesisht mbi Qeverinë e Kosovës, e cila nuk arriti të sigurojë mbështetjen e nevojshme diplomatike. Kjo analizë e zgjeruar do të shqyrtojë faktorët që çuan në këtë dështim, rolin e diplomacisë kosovare, krahasimin me raste të tjera rajonale dhe strategjitë që Kosova duhet të ndjekë për të rikuperuar këtë humbje.

2. Përgjegjësia e qeverisë në dështimin e pranimin

2.1 Qasja e ngurtë dhe mungesa e diplomacisë aktive

Qeveria aktuale ka ndjekur një qasje konfrontuese me Serbinë dhe shpeshherë edhe me aleatët

kryesorë perëndimorë. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në dështimin e Kosovës për të siguruar mbështetje të mjaftueshme për anëtarësim. Disa faktorë kyç për këtë dështim përfshijnë:

Një nga pikat kryesore që ka ndikuar negativisht është qasja e qeverisë ndaj Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i cili shihet nga partnerët ndërkombëtarë si një obligim i Kosovës nga Marrëveshja e Brukselit dhe Ohrit. Mungesa e gatishmërisë për të ecur përpara me këtë çështje ka bërë që disa shtete të BE-së të mos e mbështesin Kosovën në KiE. Përplasjet me Francën dhe Gjermaninë - Franca dhe Gjermania, dy vendet më të fuqishme në BE, kanë sinjalizuar vazhdimisht se Kosova duhet të jetë më fleksibile në dialogun me Serbinë. Mospërfillja e këtyre sinjaleve ka dobësuar mbështetjen e tyre aktive për anëtarësimin në KiE.

2.2 Mungesa e një fushate efektive lobimi

Në diplomacinë ndërkombëtare, lobimi është kyç për të siguruar mbështetje për anëtarësimin në organizata të rëndësishme. Për dallim nga vende të tjera që kanë përdorur lobimin si një strategji kyçe (si Maqedonia e

Veriut në çështjen e emrit me Greqinë), Kosova nuk ka ndërmarrë hapa të fuqishëm për të siguruar votat e nevojshme.

Shembuj konkretë të dështimit në lobim: Maqedonia e Veriut dhe Marrëveshja e Prespës (2018) - Ky shtet arriti të sigurojë mbështetje ndërkombëtare për anëtarësimin në NATO duke bërë një kompromis historik me Greqinë për çështjen e emrit. Kosova, përkundrazi, nuk ka bërë ndonjë hap konkret për të adresuar shqetësimet e vendeve skeptike.

Bosnja dhe Hercegovina dhe rruga e saj drejt BE-së - Pavarësisht krizave të brendshme, Bosnja ka ndjekur një diplomaci aktive dhe ka shfrytëzuar mbështetjen e aleatëve të saj për të përparuar në procesin e integritetit evropian. Kosova nuk ka treguar të njëjtin aftësi për të krijuar një aleancë të qëndrueshme me vendet kyçe të BE-së.

3. Roli i vendeve jo-njohëse të BE-së në dështimin e Kosovës

Një faktor tjetër kritik në dështimin e Kosovës për të hyrë në Këshillin e Evropës është mungesa e mbështetjes nga pesë shtetet e BE-së që ende

nuk e kanë njohur pavarësinë e saj:

3.1 Spanja dhe paragjykimet për integritetin territorial

Spanja ka refuzuar të njohë Kosovën për shkak të frikës se kjo mund të krijojë një precedent për Katalonjën. Qeveria Kurti nuk ka ndërmarrë ndonjë hap diplomatik për të ndryshuar këtë perceptim.

3.2 Greqia dhe lidhjet me Serbinë

Greqia ka shfaqur shenja të afrimit me Kosovën në vitet e fundit, por mungesa e një angazhimi të strukturuar nga Qeveria Kurti ka bërë që ky shtet të mbetet i pavendosur.

3.3 Rumania dhe Sllovakia

Të dyja këto vende kanë shfaqur rezerva për Kosovën për shkak të politikave të tyre të brendshme dhe marrëdhënieve me Serbinë. Një qasje më e zgjuar diplomatike mund të kishte ndihmuar në sigurimin e mbështetjes së tyre.

4. Dështimi në KiE dhe ndikimi në përpjekjet për OKB-në

Dështimi në Këshillin e Evropës krijon një efekt zinxhir që e bën më të vështirë për Kosovën të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara. Nëse Kosova do të kishte hyrë në KiE, do të kishte një bazë më të fortë për të kërkuar njohjen nga vendet skeptike dhe për të avancuar drejt anëtarësimit në OKB. Palestina dhe përpjekjet për OKB - Palestina ka përdorur një strategji të suksesshme duke siguruar anëtarësim në organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe më pas duke kërkuar pranimin në OKB. Kosova nuk ka ndjekur një

strategji të ngjashme për të rritur mbështetjen ndërkombëtare për anëtarësimin e saj.

5. Strategjitë që Kosova duhet të ndjekë për të rinjohur pozicionin e saj ndërkombëtar

Për të rikuperuar këtë humbje dhe për të siguruar suksesin në të ardhmen, Kosova duhet të ndjekë një qasje të re diplomatike: 1. Përmirësimi i marrëdhënieve me Francën dhe Gjermaninë - Këto dy shtete janë kyçe për mbështetjen e Kosovës në KiE dhe në BE. Një angazhim më i madh me to do të ishte i domosdoshëm. 2. Përdorimi i diplomacisë ekonomike - Duke ofruar marrëveshje të favorshme tregtare për shtetet skeptike, Kosova mund të rrisë mbështetjen e saj ndërkombëtare. 3. Krijimi i një strategjie lobimi me vendet jo-njohëse - Kosova duhet të punojë me Greqinë, Spanjën dhe vendet e tjera skeptike për të siguruar një ndryshim të qëndrimit të tyre.

Qeveria në të ardhmen e afërt dhe nevoja për një politikë më të zgjuar diplomatike

Dështimi në KiE nuk ishte i pashmangshëm, por ishte rezultat i një diplomacie të dobët dhe një qasjeje të ngurtë nga Qeveria në detyrë. Për të shmangur dështime të ngjashme në të ardhmen, Kosova duhet të adoptojë një strategji më të zgjuar, më fleksibile dhe të mbështetur në një diplomaci më efektive me aleatët ndërkombëtarë.



Policia e Kosovës realizon kontroll në Mitrovicë të Jugut, sekuestron narkotikë dhe dëshmi të tjera

MITROVICË, 24 SHKURT - Policia e Kosovës, konkretisht hetues të Drejtorisë së Hetimit të Trafikimit të Narkotikëve në Mitrovicë-Jug, pas pranimin të informacioneve të vlefshme nga terreni dhe në asistim të një patrulle policore pranë Stacionit Policor në Mitrovicë-Jug, kanë realizuar një kontroll në

një shtëpi dhe objektet përcjellëse në fshatin Rekë, Mitrovicë-Jug. Gjatë kontrollit si prova materiale janë sekuestruar 8 qese me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë, me peshë totale prej 8.8 gramësh; 75 qese me substancë narkotike të llojit marijuanë me peshë totale prej 106.3

gramësh; 17 fara të bimëve narkotike Kanabis Sativa; 8 fishekë të kal. 7.92x57; 1 peshore digjitale; 1 mulli për bluarjen e marijuanës dhe 1 010.00 euro para të gatshme. Në vendin e ngjarjes ka dalë Krimteknika Rajonale, e cila ka realizuar fotografimin, evidentimin, matjen dhe sekuestrimin e dëshmimeve.

Gjatë kontrollit i dyshuari nuk ka qenë i pranishëm në shtëpi, por i është lënë ftesë që të paraqitet në polici për t'u marrë në pyetje. Lidhur me këtë rast është informuar prokurori kujdestar pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda.



Hetimi për këtë rast është duke u kryer nga antidroga Mitrovicë-Jug.

Qeveria e Kosovës themelon Këshillin Shtetëror për shënimin e 27-vjetorit të Epopesë së UÇK-së

PRISHTINË, 25 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën ka miratuar themelimin e Këshillit Shtetëror për shënimin e 27-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ky këshill ka për qëllim

organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve për ta nderuar kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në çlirimin e vendit. Këshilli do të drejtohet nga ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, si kryesues, ndërsa bashkëkryesues do të jetë kryetari i komunës së

Skenderajt, Fadil Nura. Anëtarë të tjerë të Këshillit janë: Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku; Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi; Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari, Drejtori i

Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha dhe përfaqësues të organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së. Përmes këtij vendimi, Zyra e Presidentes, Kuvendi i Kosovës dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës janë ftuar të dërgojnë përfaqësues të tyre në Këshill.



Tërnavë pret zyrtaren e ShBA-së, diskutojnë për rëndësinë e lirive fetare



PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur të martën në takim zyrtar për çështje politike në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Brooke Young. Gjatë këtij takimi u diskutua për rëndësinë e lirive fetare dhe angazhimin e Bashkësisë Islame në avancimin e të drejtave dhe lirive fetare në Kosovë. Myftiu Tërnavë theksoi se

Kosova është një shembull i harmonisë fetare, ku besimtarët e feve të ndryshme bashkëjetojnë në paqe dhe respekt. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në promovimin e lirive fetare dhe respektimin e diversitetit, duke kontribuar kështu në forcimin e paqes dhe stabilitetit në vend. Nga ana e saj, Brooke Young vlerësoi lart kontributin e

Bashkësisë Islame të Kosovës dhe angazhimin e saj për t'i ruajtur dhe forcuar liritë fetare, duke theksuar faktin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin përpjekjet e Kosovës për ta promovuar tolerancën fetare dhe të drejtat e njeriut. Ajo me këtë rast theksoi rëndësinë e dialogut ndërfetar dhe bashkëpunimin për ndërtimin e një shoqërie të barabartë për të gjithë qytetarët.

Ushtarët finlandezë të KFOR-it kryejnë patrullime në veri, analizojnë kushtet aktuale të rrugëve dhe urave

PRISHTINË, 25 SHKURT - Ushtarët finlandezë të misionit të KFOR-it në Kosovë kanë kryer patrullime rutinore përgjatë vijës kufitare administrative në veri të vendit për t'i analizuar kushtet aktuale të rrugëve dhe urave. Sipas një shkrimi të publikuar në llogarinë e KFOR-it në rrjetin social "Facebook",

bëhet me dije se këto përpjekje janë pjesë e misionit të përditshëm të KFOR-it për të garantuar një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. "KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 - për të kontribuar në një mjedis të qetë dhe të sigurt

për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. KFOR-i punon ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në rolet e tyre përkatëse si reagues të sigurisë", thuhet në njoftimin e KFOR-it.



Zemaj takon admiralin Giuseppe Cavo Dragone, flasin për sigurinë, sfidat dhe stabilitetin në Kosovë dhe në rajon



PRISHTINË, 25 SHKURT - Ambasadori i Kosovës për marrëdhëniet me NATO-n, Astrit Zemaj, ka zhvilluar takim me kryetarin e ri të Komitetit Ushtarak të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (Chair of the Military Committee - NATO), Admirali

Giuseppe Cavo Dragone. Zemaj në rrjetin social në "Facebook" ka shkruar se kanë biseduar në lidhje me sigurinë, sfidat aktuale dhe stabilitetin në Kosovë dhe në rajon. "Në këtë aspekt, patëm një takim të frytshëm dhe një diskutim të sinqertë dhe të vlefshëm në

lidhje me sigurinë, sfidat aktuale dhe stabilitetin në Kosovë dhe në rajon. E falënderova CMC Admiralin Dragone për kontributin e madh dhe të vazhdueshëm të NATO-s dhe të KFOR-it në Kosovë, tashmë për rreth tri dekada, dhe në veçanti për

punën e përbashkët dhe mbështetjen për vendin tonë dhe të ardhmen tonë integruese si një partner i besueshëm dhe promovues i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në mbarë rajonin dhe më gjerë", ka shkruar ambasadori Zemaj.

Organizatave të UÇK-së nuk kanë vendosur nëse do të marrin pjesë në organizimin për epopesë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së nuk janë njoftuar ende zyrtarisht për shënimin e 27-vjetorit të Epopesë. Xhavit Jashari nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve ka thënë se nuk janë të vendosur nëse do të dërgojnë përfaqësues në Këshillin Shtetëror për shënimin e

Epopesë së UÇK-së, këshill ky i themeluar sot nga Qeveria e Kosovës. Qeveria ka themeluar Këshillin Shtetëror për shënimin e 27-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili do të kryesohet nga ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Jashari tha se deri më tani nuk

janë kontaktuar nga institucionet. "Neve nuk na ka kontaktuar askush deri më tani zyrtarisht dhe nëse na kontaktojnë apo bëjnë kërkesë për të qenë pjesë e këtij manifestimi, ulemi bashkërisht tri organizatat edhe marrim një qëndrim ose një vendim", ka thënë Jashari. (ksp)



Tarifat eventuale të ShBA-së për mallrat e BE-së mund t'i prekin eksportet e Kosovës

Eksportet e Kosovës në Shtetet e Bashkuara kanë qenë kryesisht të qëndrueshme, por tarifrat e paralajmëruara të presidentit Donald Trump për mallrat e BE-së do të mund t'i rrisin kostot e prodhimit edhe për kompanitë e Kosovës

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kompania "Frutex" nga Kosova, e cila merret me prodhimin e pijeve joalkoolike dhe energjike, nisi të eksportonte në Shtetet e Bashkuara në vitin 2019. Atëkohë vlera e eksporteve të saj i kaloi 40 mijë dollarë - vitin e kaluar arriti mbi 100 mijë. "Vlera, prapë, nuk është aq e madhe, pasi që nuk është e lehtë të depërtohet në një treg, ku konkurrenca është e fortë, Megjithatë, ne jemi të kënaqur edhe me këtë që vjen falë komunitetit të madh shqiptar në ShBA", thotë për "Radion Evropa e Lirë" pronari i kompanisë, Shaqir Palushi. Organizatat ekonomike thonë se nga viti 2019, në fakt, ka nisur edhe rritja e eksporteve të përgjithshme të Kosovës në ShBA, për shkak të rritjes së cilësisë së produkteve. Këtë e tregojnë edhe të dhënat e Doganës së Kosovës, sipas të cilave, vlera e tyre në vitin 2019 ishte tre milionë euro, ndërsa tre vjet më vonë arriti në mbi 131 milionë. Para asaj kohe, ndërkaq, ishte dukshëm nën tre milionë. "Radio Evropa e Lirë" pyeti

Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë se përse ka pasur rënie të theksuar të eksporteve në ShBA vitin e kaluar, por që nga mesi i javës së kaluar nuk mori përgjigje. Produktet që i eksporton Kosova në ShBA përfshijnë: ushqime, lëngje, tekstil, dyshekë, por dhe prodhime nga druri dhe plastika. Mallrat amerikane në tregun e Kosovës janë kryesisht produktet me origjinë shtazore, tekstili, lëndët djegëse, mjetet e transportit e të tjera.

Si arrihen produktet e Kosovës në tregun e ShBA-së?

Kosova ka një industri të vogël prodhuese, por disa kompani vendore kanë arritur të eksportojnë produkte cilësore edhe në tregjet ndërkombëtare, thotë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna. Sipas tij, faktori që ka ndikuar në rritjen e pranisë së mallrave të Kosovës në ShBA - njërin prej tregjeve më të mëdha në botë - është Sistemi i



Përgjithshëm i Preferencave (GSP).

Ky është një program tregtar i ShBA-së që u mundëson vendeve në zhvillim të eksportojnë produkte të caktuara atje pa paguar tarifa doganore.

Kosova përfiton prej tij nga viti 2012, kur i është mundësuar që rreth 3 500 produkte nga sektorë të ndryshëm t'i eksportojnë në ShBA, pa iu nënshtruar taksave doganore. "Në vitin 2019 kemi pasur disa kompani që kanë marrë hov dhe i kanë rritur prodhimet e tyre në Kosovë dhe jashtë saj. Lirimi nga taksa doganore është një gjë e leverdishme për to", thotë Rafuna për "Radion Evropa e Lirë".

Këtë e konfirmon edhe Palushi, i cili thotë se për eksportin e mallrave të tij në ShBA, paguan vetëm koston e transportit. "Mospagesa e taksës doganore e bën produktin tonë konkurrent me produktet e tjera", thotë ai, duke shtuar se aplikimi i tarifës doganore do të sillte një situatë më ndryshe.

E ndryshimet e tilla mund të mos jenë larg, sidomos pas paralajmërimeve të presidentit amerikan Donald Trump, se vendi i tij do të vendosë së shpejti tarifa mbi mallrat që

importon nga BE-ja.

Kjo ka nxitur reagimin e bllokut - tregut më të madh të vetëm në botë, nga i cili varet edhe Kosova. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se tarifrat e tilla "të pajustificuara" do të shkaktonin "kundërmasa proporcionale".

Rafuna thotë se nëse ShBA-ja i zbaton këto tarifa ndaj produkteve të BE-së dhe anasjelltas, ato në mënyrë jodirekte do ta prekin edhe tregun e Kosovës, pasi kompanitë e Kosovës varen nga importimi i produkteve të ndryshme nga tregu evropian. "Në qoftë se një lëndë e parë vjen nga ShBA-ja te një kompani gjermane me tatim doganor më të shtrenjtë, ajo lëndë e parë do të shtrenjtohet. Dhe, kur kompania jonë e blen produktin final prej asaj lënde të parë që është importuar nga ShBA-ja, padyshim se do të jetë më shtrenjtë", shpjegon Rafuna.

Sejdi Rexhepi, ligjërues i ekonomisë ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, ndan mendim të ngjashëm. Sipas tij, ekonomia e Kosovës është importuese dhe ndien çdo ndryshim që pësojnë tregjet botërore. "Kompanitë tona do të jenë të detyruara të blejnë me çmime më të larta. Kjo, sigurisht,

do të reflektohet në rritjen e çmimeve të importit dhe rrezikon të reflektojë edhe në rritjen e përgjithshme të çmimeve në Kosovë", thotë Rexhepi për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vendi vitin e kaluar ka importuar mallra në vlerë mbi 6.3 miliardë euro, kurse ka eksportuar vlerën e 941.3 milionë eurove.

Nga 27 vendet anëtare të BE-së janë importuar mallra në vlerë prej rreth tre miliardë eurosh, ose rreth 45 për qind e totalit - nisur nga produktet ushqimore deri te materialet ndërtimore. Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së, ndërkaq, kanë pasur vlerën e 294 milionë eurove, apo rreth 30 për qind e totalit.

Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës në BE, si në eksporte, ashtu edhe në importe, janë: Gjermania, Italia, Austria, Franca dhe Greqia.

Palushi thotë se, edhe nëse nis zbatimimi i taksës amerikane për mallrat e BE-së, ai nuk do ta ndërpresë eksportin, por se prodhimet e tij me siguri se do të jenë me çmime më të larta. "Besoje se konsumatorët, sidomos shqiptarët, janë të gatshëm t'i paguajnë", thotë Palushi.

Çka janë tarifrat që i paralajmëron Trump?

Tarifrat janë taksa që u ngarkohen mallrave të importuara nga vende të tjera.

Ato shihen si një mjet për të mbrojtur industrinë vendase nga konkurrenca e huaj.

Rritja e çmimit të mallrave të importuara synon t'i inkurajojë konsumatorët që

të blejnë produkte më të lira vendase dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë në rritjen e ekonomisë së tyre.

Sipas agjencisë së statistikave të BE-së, Eurostat, rreth 20 vende anëtare të BE-së kanë eksportuar më shumë se importuar nga ShBA-ja në vitin 2023.

ZRRE: Kompanitë energjetike kërkojnë rritjen e çmimit të rrymës

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kompanitë e sektorit të energjisë në Kosovë kanë bërë kërkesë për rritjen e çmimit të tarifave të rrymës, konfirmon për Radion Evropa e Lirë kreu i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji Elektrike (ZRRE), Ymer Fejzullahu. "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut [KOST], Kompania për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë [KEDS] dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike [KESCO] kanë dorëzuar aplikimet për shqyrtimin e tarifave", thotë Fejzullahu, por nuk saktëson se sa është

kërkesa e tyre për rritje.

Aktualisht, thotë ai, ZRRE-ja është në fazën e vlerësimit të këtyre aplikimeve.

Pas përfundimit të këtij procesi, ai thotë se ky institucion do të hartojë një raport të vlerësimit, i cili do të jetë i qasshëm edhe për konsultim publik.

ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e përvitshëm të tarifave të rrymës të cilat shpallen çdo 1 prill dhe vlejën deri më 31 mars të vitit pasues. Vitin e kaluar ZRRE-ja e uli çmimin për konsumatorët komercialë dhe industrialë për 3 për qind. Por, një vit më herët,

më 2023, tarifrat u rritën për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Aktualisht për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh.

Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për ata që shpenzojnë më shumë.



KOHËT E ERRËTA TË PERËNDIMIT

Të habitur, të pasigurt, të humbur, evropianët ndjekin të pafuqishëm cunamin që prej një muaji ka tronditur rendin botëror. Janë jetimë të Perëndimit



Paolo GENTILONI

Të habitur, të pasigurt, të humbur, evropianët ndjekin të pafuqishëm cunamin që prej një muaji ka tronditur rendin botëror. Janë jetimë të Perëndimit.

Amerika mbetet një demokraci e madhe, natyrisht. Dhe vala, herët a vonë, do të tërhiqet: ekzistojnë kundërpeshat institucionale, Kongresi, mediat, zgjedhjet e mesmandatit pas njëzet muajsh. Për këtë arsye, është e drejtë të mbetemi të lidhur me marrëdhëniet tona të vjetra transatlantike. Por ndërkohë, është e nevojshme të përballemi me një botë të re. Dridhen shtyllat e rendit botëror që ka mbizotëruar për tetëdhjetë vjet: ato të marrëdhënieve mes shteteve të sanksionuara nga Karta e OKB-së, ato ekonomiko-financiare të ndërtuara mbi institucionet e Bretton Woods, flamujt e Perëndimit të lirisë dhe shtetit të së drejtës, selitë multilaterale për rregullimin e tregtisë botërore, reduktimin e varfërisë, tranzicionin klimatik. Gjëra të një kohe tjetër, tashmë të shpërfillura ose të lëna në krahët e nostalgjisë. Për presidentin Trump duket se

në epokën e artë që ka premtuar, të vetmet që kanë rëndësi janë interesat sovraane. Nuk dihet nëse pas këtij vullneti për të imponuar ligjin e më të fortit fshihet një strategji e mirëfilltë, por kam frikë se autokratët do të jenë ata që do ta festojnë më shumë.

Shumica e evropianëve mendojnë ndryshe. Ata e dinë se ky rend botëror ka nevojë për një përditësim, por jo për t'u shkelur me këmbë, dhe se mbi Evropën rëndon një përgjegjësi e madhe. Kësaj përgjegjësie duhet t'i përkushtohemi me urgjencë, tani që edhe zgjedhjet në Gjermani kanë konfirmuar se, pavarësisht forcës së ekstremit të djathtë dhe fragmentimit të Bundestagut, shumica dërrmuese e votuesve janë në anën e Evropës.

Sot, tre vjet pas fillimit të pushtimit të përgjakshëm të Ukrainës nga Rusia, Ursula von der Leyen ndodhet në Kiev me liderë të tjerë evropianë. Dhe është e qartë se testi i parë i vullnetit tonë për të mos luajtur rolin e somnambulëve do të jetë pikërisht mbështetja për Ukrainën. Liderë të tjerë evropianë, i pari ndër ta sot Macron, do të jenë këto ditë në Shtëpinë e Bardhë. Në Kiev dhe në Uashington

duhen fjalë të qarta. Për Bashkimin Evropian, diktatori nuk është aspak Zelensky, i cili vazhdon të dëshmojë guxim në shërbim të vendit të tij; dhe agresori nuk është aspak Ukraina.

Në tryezë duhet të vendosen paketa të reja ndihmash evropiane, përfshirë edhe ato ushtarake, dhe gatishmëria për të lehtësuar çdo negociatë në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara, por vetëm për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme. Një dorëzim, përkundrazi, do të nënkuptonte përsheptimin e luftërave të reja në tokën evropiane.

Krah mbështetjes për Ukrainën, prioriteti i dytë është mbrojtja e përbashkët evropiane, një perspektivë që presidenca Trump mund ta bëjë më në fund të realizueshme. Nuk mjafton të shpenzosh disa dhjetëra pikë përqindje më shumë të PBB-ve kombëtare, sepse nëse nuk reduktohet fragmentimin dhe shpërdorimet, nuk do të kemi as një industri dhe as një mbrojtje të vërtetë evropiane. Nuk ka kuptim të vihet përballë financimi i mbrojtjes dhe ai i zhvillimit, sepse nëse duam një paqe të qëndrueshme, do të duhet ta mbrojmë atë,

kryesisht vetë; dhe nëse nuk jemi në gjendje të mbrohemi, edhe sistemi ynë i mirëqenies do të jetë në rrezik. Nevojiten blerje të përbashkëta dhe sisteme mbrojtjeje evropiane, me synimin e një mbrojtjeje të përbashkët që plotëson NATO-n.

Ukraina dhe mbrojtja e përbashkët nuk janë sfidat e vetme për Bashkimin Evropian. Raportet e fundit të Mario Draghi-t dhe Enrico Lettës kanë hartuar një agjendë të shkëlqyer për prioritetet e një tregu të vetëm konkurrues. Dhe në sfond duket se po shfaqet madje ndonjë dritë e së ardhmes, siç kur kandidati për kancelar, Friedrich Merz, aludon për një lloj evropianizimi të force de frappe franceze. Ndoshta, shtoj unë, e shoqëruar me një fillim evropianizimi të Buxhetit dhe Thesarit. Një skenar, ende i largët sot, që mund të rihapë mundësinë e një shkëmbimi të madh si ai që në vitet nëntëdhjetë mundësoi ribashkimin e Gjermanisë dhe lindjen e euros.

Ora më e errët e Perëndimit mund të jetë – duhet të jetë – ora e Evropës. Në vendet evropiane, forcat kundër Bashkimit janë pakicë, por një pakicë aspak e heshtur.

Mbështetësit e Bashkimit, përkundrazi, janë shumicë e madhe, por e kanë të vështirë të bëjnë zërin e tyre të dëgjohej. Dhe shpesh, zëri i tyre duket më shumë kritik sesa mbështetës ndaj Evropës.

Tani dobësia, vonesat, përçarjet mes vendeve janë më se të dukshme. Po aq e dukshme është edhe nevoja për të reformuar Bashkimin dhe për të dalë nga kafazi i vetokracisë. Por pa Evropën, pa fuqinë e saj tregtare, pa modelin e saj social, pa vlerat e saj të lirisë, do të jemi thjesht në mëshirë të cunamit. Dhe nëse ky është vërtet një moment i rëndë, ndoshta është koha për të ndalur ankesat e vazhdueshme mbi kufizimet e BE-së. Do të shpallja një moratorium mbi vetëdenigrimin, për t'u bashkuar, të paktën në këto muaj, rreth fatit tonë të përbashkët, të ndërlikuar, por të jashtëzakonshëm evropian. Për të integruar patriotizmin tonë kombëtar me një patriotizëm të shëndetshëm evropian. Madje duke adoptuar një slogan që përdoret në anën tjetër të Atlantikut: right or wrong, it's my Europe.

lN° shqip nga bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



‘Dardanet’ pësojnë ndaj Letonisë

PRISHTINË, 25 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar humbje 1-0 në shtëpi ndaj Letonisë në kuadër të Ligës së Kombeve, Liga C. Pjesa e parë solli

shumë raste për vashat tona, por që ato nuk ia dolën t'i konkretizonin me gol, andaj 45 minutat e parë përfunduan pa gol. Por, në pjesën e dytë, përkatësisht në minutën e 51-

të, letonezet shënuan golin e epërsisë nëpërmjet Zaicikova. Vashat e Kosovës nuk ia dolën ta barazonin rezultatin, duke shpërdoruar disa raste të mira. Letonia me këtë fitore

është në vendin e parë me tri pikë pas dy xhirove të zhvilluara, aq sa kanë edhe vashat tona, ndërsa ato të Maqedonisë së Veriut janë pa pikë.



Presidentja Osmani priti në takim gjimnastet kampione, motrat Lisa dhe Vilëza Zeqiri dhe Vilëza Zeqiri

PRISHTINË, 25 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, priti në takim gjimnastet kampione, motrat Lisa dhe Vilëza Zeqiri, të cilat janë pjesë e Klubit të Gjimnastikës “Elita” si dhe trajneren e tyre Abeliana Bregu. “Vilëza dhe Lisa e njoftuan presidenten Osmani për angazhimin e tyre në sportin e gjimnastikës, sukseset e vazhdueshme ndër vite në këtë sport dhe planet e tyre për të ardhmen. Po ashtu, edhe trajnerja e tyre Abeliana foli për

sfidat që kanë në këtë sport dhe ecurinë e së ardhmes të Klubit “Elita”, thuhet në njoftimin e presidencës. Presidentja Osmani me këtë rast ka theksuar se suksesi i Lisës dhe Vilëzës në gjimnastikë tregon se sportistëve në secilin sport duhet t'u ofrohet mundësia për përkrahje në mënyrë që të arrijnë suksese në arenën ndërkombëtare dhe t'i sjellin rezultate të mira Republikës së Kosovës, pasi ata janë promovimi më i mirë i vendit tonë.



Sot zhvillohen dy ndeshjet çerekfinale të Kupës

PRISHTINË, 25 SHKURT - Sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte) do të luhen ndeshjet çerekfinale të Kupës së Kosovës në futboll, ku edhe do të përcaktohen skuadrat gjysmëfinaliste të kësaj gare, që është rruga më e shkurtër për të trofeu dhe garat evropiane. Sot nga ora 13:00 janë dy ndeshjet e para çerekfinale, ku do të përballen Drenica - Ferizaj dhe Malisheva - Llapi. Megjithatë, vëmendja do të jetë te dueli i skuadrave të Superligës të cilat fokusin e kanë të Kupa e Kosovës dhe vikendin e shkuar u përballen në Superligë ku luajtën pa gola. Malisheva është e treta në Superligë me 34 pikë, 12 më shumë se Llapi që renditet i



parafundit në tabelë. Edhe të enjten, gjithashtu, janë dy ndeshje që nisin në orën 13:00, ku do të përballen Vëllaznimi - Prishtina dhe Prishtina e Re - Drita. Prishtina dhe Drita, ekipe që garojnë në Superligë, vlerësohen favorite përball Vëllaznimit e Prishtinës së Re që janë pjesë e Ligës së Parë.

Fetahu: E ardhmja e Kosovës është e ndritur

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kosova i dha fund ëndrrës për kualifikim në Kampionatin Botëror të Basketbollit që zhvillohet në vitin 2027 pasi humbja nga Zvicra në Prishtinë shoi të gjitha gjasat e “Dardanëve” për të vazhduar tutje. Përkundër këtij eliminimi, kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, ka thënë se menjëherë do të fillojnë punën për parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2029, që do të fillojnë në nëntor të vitit 2025. “Pavarësisht prej përfundimit të kësaj gare, ne nuk do të ndalemi këtu. Sytë tanë janë të drejtuar drejt së ardhmes – parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2029, që do të



fillojnë në nëntor të vitit 2025. Presim me padurim shortin gjatë verës dhe do t'i vazhdojmë përgatitjet me përkushtim dhe vendosmëri”, ka thënë Fetahu për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka shtuar se do të punohet shumë me klubet për gjeneratat e reja pasi, sipas tij, aty është e ardhmja e basketbollit të Kosovës. “Ne jemi të

përkushtuar që të punojmë edhe më shumë me klubet dhe grupet e tjera të interesit për ta zhvilluar basketbollin e të rinjve, të cilët janë e ardhmja e Përfaqësueses së Kosovës. E ardhmja është e ndritur dhe së bashku, me punë të palodhshme dhe përkushtim, do ta ndërtojmë atë”, ka thënë Fetahu.


‘Shqipëri & Serbi 2027’, Çeferin: Sporti mbi politikën

TIJANË, 25 SHKURT - Në një intervistë për gazetën sllovene “Delo”, numri një i UEFA-s është pyetur mbi organizimin e Euro 2027 nga Shqipëria dhe Serbia. Për Aleksandër Çeferin ky hap mund të jetë një “shembull” i mirë që

futbolli i jep politikës. “Nuk e mohoj se kam një dashuri të veçantë për të gjithë vendet e ish-Jugosllavisë, por më vjen keq që në dekadat e fundit Ballkani ka qenë me të vërtetë i trishtë. Mendoj se deri më tani është gabuar nga liderët e

këtyre vendeve, të cilët kanë biseduar me burokratët evropianë, të cilët nuk dinë mentalitetin e banorëve të atyre trojeve”, ka thënë ai. “Sa i përket këtij eventi, më duhet të them se të dy qeveritë i kanë mbështetur fort

federatat e vendeve respektive të cilat shprehën dëshirën për të organizuar një event si Evropiani për moshat deri në 21 vjeç. Kjo është një tjetër provë se futbolli është mbi politikën. Sporti është diçka e mirë”, ka shtuar Çeferin.




Messi, gati të rikthehet në Barcelonë

Barcelonë, 25 shkurt - Gazetari i njohur i futbollit Alex Candal ka zbuluar se destinacioni i radhës i Lionel Messit mund të jetë Barcelona. Ky lajm vjen pas përfundimit të kontratës aktuale të Messit me Inter Miamin në fund të vitit, me sulmuesin që nuk ka gjasa të vazhdojë më tej. Sipas "Candal", Messi ka shprehur

dëshirën e tij për të luajtur në "CampNou"-n e ri, duke thënë: "Nuk mund ta lë futbollin pa luajtur në 'CampNou'-n e ri". Ky zhvillim ka shkaktuar tronditje në të gjithë botën e futbollit, me shumë njerëz që pyesin nëse Barcelona ka mjetet ekonomike për t'i siguruar shërbimet e Messit. Rikthimi i mundshëm i Messit në

"CampNou" do të ishte një lëvizje e rëndësishme për klubin, por nuk është pa sfida. Marrëdhënia e prishur e argentinasi me presidentin e Barcelonës, Joan Laporta, do të duhet të korrigjohet dhe është e paqartë nëse Messi do të përshtatet në organizimin aktual sportiv të klubit. Pavarësisht prej këtyre

pengesave, ndikimi i Messit në Barcelonë nuk mund të mbivlerësohet. Paraqitjet e tij në skenën ndërkombëtare tregojnë se ai është ende i aftë për të konkurruar në nivelin më të lartë. Vetë lojtari ka lënë të kuptohet për dëshirën e tij për t'u rikthyer te Barcelona në të kaluarën, duke e bërë këtë zhvillim edhe më intrigues.



Superliga rikthehet me duele interesante

PEJË, 25 SHKURT - Mesjava sjell duelet e javës së 21-të të Pro Credit Superligës, që është shtyrë për shkak se palestrat ishin të zëna për zgjedhjet në Kosovë. Golden Eagle Ylli dhe Proton Cable Prizreni përballen në një duel mjaft interesant, por edhe shumë të rëndësishëm. Therandasit janë në vendin e gjashtë me tetë fitore e 12 humbje, derisa prizrenasit në vendin e tetë me pesë fitore e 15 humbje. Fitorja është shumë e rëndësishme për të dyja skuadrat, duke bërë që të presim një sfidë mjaft interesante. Dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës, Peja dhe Bashkimi, përballen në një takim mjaft interesant. Pejanët janë në vendin e pestë me dhjetë fitore e dhjetë humbje, kurse



prizrenasit në vendin e dytë me 14 fitore e gjashtë humbje. Dueli i vetëm i së enjtes ndërmjet Borës dhe Trepçës.

Prishtinasit janë në vendin e shtatë me gjashtë fitore e 14 humbje, kurse mitrovicasit kanë 14 fitore e gjashtë humbje.

PRO CREDIT SUPERLIGA - JAVA 21

Të mërkurën takohen:
19:00 Golden Eagle Ylli - Proton Cable Prizreni
19:00 Peja - Bashkimi

Të enjten takohen:
19:00 Bora - Trepça

Oklahoma humbet në shtesë, fitojnë Detroiti dhe Denveri

OKLAHOMA, 25 SHKURT - Oklahoma ndalet në kohë në shtesë në përballjen ndaj Minnesotas, ku u mund me rezultat 131-128, ndeshje ku u dallua Jaden McDaniël me 27 pikë. Gjithsesi, skuadra e Thunderit ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit. Jashtë fushës fitoi Denveri, që mundi me rezultat 125-116 Indianan. Gordonit me 25 pikë udhëhoqi skuadrën e Nuggetsit, me 6 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë. Fitore të lehtë korri Chicago, që falë 48 pikëve të dysheve Giddey - Huerter, mundi me rezultat 142-110



Philadelphian. Ekipi i Detroitit mundi me shifrat 106-987 clippersat në një përballje të ekuilibruar.

Cunningham me 32 pikë ishte lider për vendësit. Zhgënjëu Miami, që u mund me rezultat 98-86 nga Atlanta. Vendimtar stoli i ekipit vendës, nga erdhën 49 pikë.

REZULTATET

| | |
|------------------------|---------|
| Detroit - Clippers | 106-97 |
| Indiana - Denver | 116-125 |
| Philadelphia - Chicago | 110-142 |
| Washington - Brooklyn | 107-99 |
| Atlanta - Miami | 98-86 |
| Oklahoma - Minnesota | 128-131 |
| Utah Jazz - Portland | 112-114 |
| Sacramento - Charlotte | 130-88 |

SHKURT

Jashari është përfshirë në formacionin e javës në Superligën e Ukrainës

Futbollisti nga Kosovar dha kontribut të madh në fitoren e LNZ Cherkasy ndaj Rukh Lviv me rezultat 1:0. Në ndeshjen e së shtunës, në kuadër të xhiros së 18, përfaqësuesi nga Kosova e dhuroi asistimin për golin e fitores, të shënuar qysh në minutën e tretë nga Vyacheslav Tankovskiy. Për këtë, faqja e specializuar për vlerësimin e lojtarëve - Sofascore - e ka përfshirë 27-vjeçarin në ekipin ideal të javës së 18, duke e vlerësuar me notën 8.2.

Kastrioti fiton në kryeqytet

Kastrioti ka mposhtur Prishtinën në kryeqytet. Ndeshja e xhiros së 19 të Superligës së Kosovës në hendboll e zhvilluar të hënën mbrëma përfundoi me rezultat 42:31 për ferizajasit. Kastrioti nisi shkëputjen pas minutës së 20, derisa në pjesën e dytë mbajti epërsi bindëse. Me 15 gola të shënuara më efikasitet Kastrioti ishte Deniz Terziqi. 10 i shënoi Lulzim Shabani, kurse gjashtë gola i kishte Yassine Henahen. Oltion Beshiri e Enis Kuleta i realizuan nga tetë gola te Prishtina. Pesë i kishte Albi Gjuka e katër Ylli Visoka. Kastrioti është i tretë me 26 pikë nga 18 ndeshje. Prishtina mbetet e katërta me 17 pikë.

Galatasaray me veprime ligjore kundër Mourinhos

Barazimi pa gola në derbin e Stambollit nuk ka kaluar pa polemika. Shkak janë bërë deklaratat e teknikut Jose Mourinho me teknikun e Fenerbahçe që ka shpërthyer në akuza ndaj stolit të Galatasarayt. Sipas pretendimeve të tyre, portugezi i është drejtuar me fjalët "kërcejnë si majmunët", duke iu referuar festimeve të marrjes së një pike. Galatasaray konfirmoi se do të fillonin veprimet ligjore kundër Jose Mourinhos për deklaratat të supozuara. Klubi e dënoi me vendosmëri sjelljen e tij, duke deklaruar se veprimet e tij kishin përparuar nga "komente imorale" në "gjuhë çnjerëzore". Klubi turk ka dërguar një ankesë zyrtare si në FIFA ashtu edhe në UEFA, duke u kërkuar autoriteteve të futbollit që të ndërmarrin veprime kundër Mourinhos.

Unitedi pushon edhe 200 punëtorë nga puna

Masat shtrënguese te Manchester Unitedi në udhëheqjen e re të miliardarit Sir Jim Ratcliffe vazhdojnë dhe rreth 200 njerëz do ta humbasin punën e tyre në valën e re të pushimeve nga puna. "Djajtë e Kuq" kanë qenë në humbje financiare për pesë vjet radhazi dhe vendimi i Ratcliffes për të pushuar nga puna 250 punonjës vitin e kaluar, përfshirë legjendarin Sir Alex Ferguson, nuk ka dhënë fryte. Prandaj, Ratcliffe ka vendosur të pushojë nga puna edhe 200 punonjës të tjerë, dhe për ata që kanë mbetur, ai ka vendosur ta eliminojë ushqimin e nxehtë, thuhet në një deklaratë të klubit nga "Old Trafford". Domethënë, vetëm lojtarët do të kenë të drejtë të hanë me shpenzimet e klubit, ndërsa të gjithë punonjësit e tjerë, përfshirë trajnerin Ruben Amorim, u lejohet të hanë supë dhe sandviçë me shpenzimet e klubit. Siç llogaritet nga kontabilistët e Manchester Unitedit, klubi do të kursejë më shumë se një milion euro në vit me këtë vendim.

Benzema i kundërpërgjigjet CR7-shit: Më i miri është Ronaldo, ai i Brazilit

Karim Benzema dhe Cristiano Ronaldo kanë ndarë vite të lavdishme te Real Madridi, duke fituar tituj, shënuar gola dhe pasur respekt të ndërsjellë. Megjithatë, reagimi i sulmuesit francez, kur u pyet për

deklaratat e fundit të CR7, ku ai pohonte se ishte lojtari më i mirë në histori, ka bërë bujë në rrjetet sociale.

Gjatë një interviste me "TNT Sports BR", Benzema nuk hezitoi ta jepte mendimin:

"Secili thotë çfarë të dojë. Nëse ai mendon se është më i miri në histori? Për mua, për shembull, më i miri është Ronaldo, ai i Brazilit".

Francezi, gjithashtu, u përpoq t'i shmangte krahasimet mes

lojtarëve dhe theksoi respektin e tij për karrierën e Cristiano: "Nuk më pëlqen të bëj krahasime mes lojtarëve. Mendoj se secili ka historinë e vet. Edhe ai ka të tijën. Është një lojtar shumë i mirë".

Fjalët e Benzemas kanë shkaktuar reagime të ndryshme, me disa tifozë që mbështesin opinionin e tij se Ronaldo Nazario është më i miri, ndërsa të tjerë besojnë se Cristiano e meriton këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qera të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 datë 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 25.02.2025 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike T-25-3

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Besim Xhemajli
E-mail: besim.xhemajli@trepcasha.com
Telefoni: +381 28 538 050
Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave dhe objekteve
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

Loti 1

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|---------------------------------|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | P-71208128-01076-1 (Pjesërisht) | 750.00 | 0.59 | 442.5 | 79.650 | 39.83 | 482.33 |

Loti 2

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|---------------------------------|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | P-71208128-01113-0 (Pjesërisht) | 1003.77 | 0.59 | 592.2243 | 106.600 | 53.30 | 645.52 |

Loti 3

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|---|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | P-71208128-01113-0 / 01112-2 (Pjesërisht) | 822.07 | 0.59 | 485.0213 | 87.304 | 43.65 | 528.67 |

Loti 4

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|---|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | P-71208128-01112-2 / 01111-0 / 01113-0 (Pjesërisht) | 1209.47 | 0.59 | 713.5873 | 128.446 | 64.22 | 777.81 |

Loti 5

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|---------------------------------|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | P-71208128-01076-1 (Pjesërisht) | 1,622.84 | 0.59 | 957.4756 | 172.346 | 86.17 | 1043.65 |
| 2 | P-71208128-01116-0 (Pjesërisht) | 387.14 | 0.59 | 228.4126 | 41.114 | 20.56 | 248.97 |
| 3 | P-71208128-01117-0 (Pjesërisht) | 183.22 | 0.59 | 108.0998 | 19.458 | 9.73 | 117.83 |
| 4 | P-71208128-01119-2 | 503.80 | 0.59 | 297.242 | 53.504 | 26.75 | 323.99 |

Loti 6

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|------------------------------|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | P-71914059-017123-0 (Lokali) | 133.76 | 5.5 | 735.68 | 132.422 | 66.21 | 801.89 |
| 2 | P-71914059-017123-0 (Banjo) | 27.20 | 5.5 | 149.6 | 26.928 | 13.46 | 163.06 |
| 3 | P-71914059-017123-0 (Zyre) | 15.51 | 5.5 | 85.305 | 15.355 | 7.68 | 92.98 |
| 4 | P-71914059-017123-0 (Hyrja) | 14.28 | 5.5 | 78.54 | 14.137 | 7.07 | 85.61 |
| 5 | P-71914059-017123-0 (Terasa) | 47.04 | 2.5 | 117.6 | 21.168 | 10.58 | 128.18 |

Loti 7

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|---------------------------|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | Porta e Nderesës afariste | 15.00 | 11.88 | 178.2 | 32.076 | 16.04 | 194.24 |
| 2 | Sipërfaqja e jashtme | 100.00 | 0.60 | 60 | 10.800 | 5.40 | 65.40 |

Loti 8

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|----------------------------|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | Parcela P-71208128-01076-1 | 1,000.00 | 0.59 | 590 | 106.200 | 53.10 | 643.10 |

Loti 9

| Nr | Objekti | Sipërfaqja (m ²) | Çmimi neto (€) | Çmimi pa TVSH | TVSH 18 % | Tatimi 9 % | Totali për pagesë |
|----|--|------------------------------|----------------|---------------|-----------|------------|-------------------|
| 1 | Parcela P-71208128-00994-0,01288-0,01286-2,01289-0,01290-0 | 4,400.00 | 0.45 | 1980 | 356.400 | 178.20 | 2158.20 |

Kriteret e Dhënies: Dhënie e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë
Data e shpalljes: 25.02.2025
Sqarimi: deri me 12.03.2025
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 12.03.2025
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet në formë fizike (zarf të mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 12.03.2025 në 11:00
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohen.

Aneksi 1 OFERTA

| | |
|------------|--|
| Emri i OE: | |
| Loti | |
| Kodi (T) | |

| Llogaritja e vlerës së qerasë | |
|-------------------------------|--|
| a | Sipërfaqja e mbuluar m ² |
| b | Çmimi për metër katrorë (€) |
| c = b*18% | Çmimi për metër katrorë me TVSH (€) |
| D=a*c | Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€) |
| e | Sipërfaqja e pa mbuluar m ² |
| f | Çmimi për metër katrorë (€) |
| g = f*18% | Çmimi për metër katrorë me TVSH (€) |
| H=e*g | Vlera e qerasë për sipërfaqen e pa mbuluar (€) |
| I=D+H | Gjithsejt qeraja (€) |

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

| | |
|-------------|--|
| Nënshkrimi: | |
| Data: | |
| Vula: | |

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 datë 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

| Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) | |
|---|--|
| Emri i OE: | |
| Adresa e plotë: | |
| I përfaqësuar nga: | |
| Emri: | |
| Pozita: | |
| E-mail: | |
| Tel: | |
| Nënskrimi: | |
| Data: | |
| Vula: | |

Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 14.05.2024 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m² dhe llogaritja përfundimtare në faturim.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkolla Fillore dhe e Mesme "Zenit" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70574632.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Komuna e Gjakovës
Opština Gjakovica Gjakovë Municipality
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË
Nr. 44
Data: 21.02.2025



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË

KE: 0390/ 320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/ 324 268
Web:

NUI: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 140200001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT – Nr.01/2024 për Regullimin e Porcedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 pika 1,2 dhe 3 e Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve dhe Vendimit Nr.43 i datës 21.02.2025 U.D. Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L."Stacioni i Autobusëve"Sh.A.,Gjakovë, shpallë këtë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

I.Pozita e punës: Zyrtar për mbrojtje të shëndetit dhe siguri në punë

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

Detyrat e punës:

- Të zhvillojë strategjinë, politikat dhe procedurat e sigurisë në punë sipas kërkesave të ligjeve në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.
- Të sigurohet që stafi i ka kuptuar drejtë dhe të punësuarit janë në dijeni të këtyre kërkesave dhe standarteve të sigurisë në punë.
- Të sigurohet që kërkesat e sigurisë në punë të zbatohen.
- Të identifikojë mënyrat e reduktimit apo eliminimit të rrezikut në punë.
- Të jetë në kontakt me rregulloret shtetërore për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Kryen dhe punë të tjera nga fushë-veprimtaria e vetë, dhe punë të tjera sipas kërkesave të Shefit të Stacionit dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit të Stacionit dhe KE.

Kushtet:

- Bachelor për siguri në punë ose emergjenca,
- Së paku 2 vite përvojë pune,
- Shkathësi në punë dhe njohja e punës me programe kompjuterike.

Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

II.Pozita: Laurist / Porter

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Regjistron hyrje-daljet e autobusëve dhe mban evidence për emrin e firmës, relacionin dhe kohën e nisjes;
- Verifikon operatorët me rastin e lëshuarjes së objektit se, a i kanë në rregull fletëleshimet- biletën e paguar të peronizimit për relacionin në fjalë dhe në librin e posaqem të evidencës regjistrojnë kohën e daljes;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Stacionit.

Kualifikimet

- Përgaditje mesme shkollore;
- 1 (një) vit përvojë pune e domosdoshme;
- Të jetë i aftë për punë me presion dhe të ketë shkathësi në kordinimin e punëve rutimore;
- Të jetë komunikues dhe të njoh ndonjë gjuhë të huaj;
- Njohja e punës me programe kompjuterike përparësi;

Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj

III. Pozita: Rojtar

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Bën sigurimin e objektit të kompanisë dhe hapsirave përreth;
- Në rast të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve tjera ndërmerr masat më efektive dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitimin e të metave;
- Në rast sulmi ndërmerr masa të caktuara konform rregullores mbi punën e shërbimit në sigurimin fiziko – teknik të objekteve;
- Të gjitha të metat e vërejtura i shënon në libër të vërejtjeve dhe mbi të njejtat e informon personin përgjegjës të tij;
- Bën kontrollimin e materialeve, objektit ,automjeteve dhe personave të cilët hyjnë dhe dalin në ndërtesë,njëherit në libër i shënon hyrjet dhe daljet e tjera në kohën kur nuk punohet ose jashtë orarit;
- Nuk lejon daljen e mjeteve në tërësi nga objekti , nëse për këtë nuk posedon një urdhër me shkrim ;
- Bartë uniformën dhe mjetet tjera të lejuara për sigurim,përdorimi i së cilave në mënyrë precize është përcaktuar në rregullat e shërbimit të rojtarëve dhe udhëzimet e udhëheqësit drejtpërdrejtë;
- Shënon kohën e ardhjes dhe daljes së punëtorëve në kohën jashtë orarit të punës;
- Në rastet e vizitës nga ana e udhëheqësit ose personit të autorizuar,ai i raporton mbi gjendjen dhe gjërat e vërejtura gjatë orarit të punës;
- Pranimin dhe dorëzimin e detyrës e bën me shkrim;
- Kryen edhe detyra të tjera, të cilat ia cakton Shefit të Stacionit dhe KE
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit të stacionit dhe KE.

Kualifikimet:

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm,
- Të kenë së paku 1 vjet përvojë pune përkatëse;
- Të ketë të kryer trajnimin dhe të posedoj certifikaten e zjarrfikësve;

Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj

Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, Aplikacioni të dorëzohet në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

- Vlefshmëria për aplikim zgjat **30 Ditë** duke filluar nga data e publikimit të Konkursit, gjegjësishtë mbyllet me datë **25.03.2025** ditë e **Martë** në ora **16:00**.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

Vërejtje: Të cektet qartë titulli i vendit të punës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

